



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

Komisioni i Ankimimeve dhe Sanksioneve

Data: 13.06.2023

Nr: 178

Ora: 21:00

VENDIM

**PËR SHQYRTIMIN E KËRKESAVE ANKIMORE NR. 67, DATË 20.05.2023 DHE NR. 74, DATË
22.05.2023**

Komisioni i Ankimimeve dhe Sanksioneve në mbledhjen e datës 13.06.2023, me pjesëmarrjen e:

Koli	BELE	-	Relator
Elvin	LAKO	-	Anëtar
Elvis	ÇEFA	-	Anëtar
Ilirjan	RUSMALI	-	Anëtar
Ledio	BRAHO	-	Anëtar

Shqyrtoi çështjen me:

ANKUES 1: Koalicioni “Bashkë Fitojmë”, përfaqësuar nga z. Altin Kaziaj;

ANKUES 2: Z. Lefter Maliqi, kandidat i koalicionit “Bashkë Fitojmë” për kryetar bashkie Kuçovë, përfaqësuar nga z. Arben Llangozi dhe zj. Orgesa Serani.

PALË E INTERESUAR: Subjekti zgjedhor “Partia Socialiste e Shqipërisë”, përfaqësuar nga z. Maringlen Legisi.

OBJEKT: (1) Ndryshimin e vendimit nr. 101, datë 16.06.2023 të ZAZ-së nr. 64, bashkia Kuçovë, qarku Berat “Për miratimin e tabelës përmbledhëse të

rezultateve për zgjedhjen e kryetarit të bashkisë Kuçovë” (kërkesë e ankuesit 1 dhe e ankuesit 2).

(2) Rinumërim dhe rivlerësim i votave për ZAZ-në nr. 64, të gjitha QV-të, duke përfshirë në të rezultatin e dalë nga rinumërimi dhe rivlerësimi i votave për QV-të e listuara në tabelë (kërkesë e ankuesit 1 dhe e ankuesit 2).

(3) Pavlefshmëri e vendimit nr. 101, datë 16.05.2023 “Për miratimin e tabelës përmbledhëse të rezultateve për zgjedhjen e kryetarit të bashkisë Kuçovë” (kërkesë e ankuesit 2).

(4) Konstatim i pavlefshmërisë së vendimit të KQZ-së ku është emëruar sekretari i KZAZ-së nr. 64 Kuçovë, shtetasi Romeo Arizi (kërkesë e ankuesit 2).

(5) Pavlefshmëri e vendimit të KZAZ-së nr. 64 Kuçovë, qarku Berat, për shtyrjen e numërimit të votës, nga ora 10:00 deri në orën 12:30 (kërkesë e ankuesit 2).

(6) Pavlefshmëri e pjesëshme e fletës së votimit Kandidatët për Kryetar Bashkie për Bashkinë Kuçovë, në pikën ku është shënuar kandidati për bashkinë Kuçovë, qarku Berat, kreshnik Hajdari (kërkesë e ankuesit 2).

(7) Pavlefshmëri e veprimit juridik, formulari i dekriminalizimit, në emër të kreshnik Hajdarit dorëzuar pranë KQZ referuar ligjit nr. 138/2015 “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike” (kërkesë e ankuesit 2).

BAZË LIGJORE:

Nenet 123/1 dhe pika 3 e nenit 124 të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar.

Rrethanat e çështjes:

1. Në datën 14.05.2023, në 61 bashki në Republikën e Shqipërisë u zhvilluan zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore. Zona zgjedhore bashkia Kuçovë ka një zonë administrimi zgjedhor (ZAZ), përkatësisht ZAZ nr. 64. Pas përfundimit të procesit të numërimit të votave, KZAZ-ja nr. 64 plotësoi, miratoi dhe depozitoi në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve tabelat përmbledhëse të rezultateve për zgjedhjen e Këshillit të Bashkisë Kuçovë dhe për zgjedhjen e Kryetarit të Bashkisë Kuçovë, vendimet përkatëse për miratimin e tabelave përmbledhëse të rezultateve, si dhe tabelat origjinale të rezultatit për çdo qendër votimi si për kryetarin dhe për këshillin, të ZAZ-së së sipërcituar.
2. Më datë 16.05.2021, me vendimin nr. 101, KZAZ nr. 64 vendosi miratimin e Tabelës Përmbledhëse të Rezultatit të zgjedhjeve për Kryetar të Bashkisë dhe për Këshillin e Bashkisë, në zonën zgjedhore Bashkia Kuçovë, për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 14 Maj 2023.
3. Kundër këtij vendimi ka paraqitur kërkesë ankimore subjekti zgjedhor, koalicioni “Bashkë Fitojmë”, përfaqësuar nga z. Altin Kaziaj, duke kërkuar kundërshtimin e vendimit të KZAZ-së, si më lart cituar, si dhe rinumërim dhe rivlerësim të votave të vlefshme dhe të pavlefshme për të gjitha QV në zonën zgjedhore bashkia Kuçovë. Pala ankimuese pretendon se ka konstatuar problematika dhe parregullsi të procesit zgjedhor të ndodhura në ZAZ nr. 64 dhe qendra të votimit të bashkisë Kuçovë.
4. Subjekti ankues, në kërkesën ankimore parashtron se:
 - Ka patur probleme me kamerat e sigurisë në pjesën më të madhe të qendrave gjatë gjithë paradites;
 - Ka patur probleme me përdorimin e pajisjes PEI;
 - Në QV nr. 3417, Krekëz, është votuar manualisht për 50 qytetarë, 45 prej të cilëve nuk figurojnë në sistemin TIMS brenda territorit të Republikës së Shqipërisë në ditën e votimit;

- Ka patur raste të votimit në grupe;
- Gjatë dorëzimit të kutive janë konstatuar parregullsi dhe janë dorëzuar dorazi vulat nga komisionerët dorëzues të disa qendrave;
- Në disa qendra votimi janë rihapur kutitë e materialeve zgjedhore pasi fillimisht janë mbyllur pa plotësuar të gjitha zërat e kërkuar në tabelën e rezultateve, osë janë mbyllur pa u futur procesverbali i mbylljes, ose për shkak se në disa raste vulat e mbylljes nuk përputheshin;
- Votat në disa kuti të kandidatit për Kryetar Bashkie ishin të njollosura me bojë vule, në disa raste nuk dallohej dot prej bojës as shenja e votimit;
- Në Librin e Protokollit është shënuar nisja e votimit në orën 24:00, por në fakt për shkak të një shkëputje të paarsyetuar nga anëtarët e KZAZ-së, u shty në orën 12:30;
- Në listën e kandidatëve për këshill bashkiak ndodhen dy individë që kanë qenë në funksione gjatë procesit të votimit, përkatësisht njëri përdorues i pajisjes PEI në një qendër votimi dhe tjetri numërues gjatë procesit të numërimit;
- Në procesin e votimit kanë qenë të përfshirë punonjës bashkie dhe funksionarë;
- Në kutitë e votimit në disa QV është konstatuar se mungonte procesverbali origjinal i mbylljes, përkatësisht në QV 3517/01, 3523/01, 3525/00, 3525/03, 3529/00, 3527/00 dhe 3517/01.
- Ka patur mosrakordim në numër votash fizikisht në kuti me atë të shënuar në procesverbale;
- Subjekti ankues pretendon se në Tabelat Përmbledhëse dhe Librin e Protokollit të KZAZ-së, janë gjendur parregullsi të shumta që kanë cenuar procesin e votimit, të numërimit dhe të identifikimit korrekt të votës;

- Në ambientet e VNV nuk ka funksionuar mirë kamera e sigurisë, e cila nuk mbulonte dot tavolinën nr. 5 të numërimit dhe një ambient shtesë ku vendoseshin materialet, tek e cila pas një dollapi në këtë ambient shtesë, ka patur një derë kalimi lidhëse me ambiente të shkollës së mesmë ngjitur.
5. Kundër vendimit nr. 101, datë 16.05.2023 të KZAZ nr.64 ka paraqitur gjithashtu kërkesë ankimore z. Lefter Maliqi, kandidat i koalicionit “Bashkë Fitojmë” për kryetar bashkie Kuçovë.
6. Në kërkesën e tij ankimore, subjekti ankues ka listuar të njëjtat konstatime dhe pretendime si ato të përfshira në kërkesën ankimore të depozituar nga përfaqësuesi i koalicionit “Bashkë Fitojmë”. Pretendime të tjera të ankuesit z. Maliqi janë si më poshtë:
- Formulari i vetëdeklarimit i depozituar nga kandidati i subjektit zgjedhor “Partia Socialiste e Shqipërisë”, për kryetar bashkie Kuçovë, z. Kreshnik Hajdari është absolutisht i pavlefshëm, sepse ky i fundit rezulton i dënuar në Greqi për akuzën e “Kalimit të Paligjshëm të Kufirit”, fakt të cilin nuk e ka deklaruar në formularin e dekriminalizimit.
 - Referuar pretendimit të mësipërm, edhe fleta e votimit për kryetarin e bashkisë Kuçovë është e pavlefshme, për pjesën ku është shënuar emri i kandidatit Kreshnik Hajdari;
 - Rreth 3000 vota në kutitë e fundit janë të pavlefshme dhe nuk kuptohet se ku është vendosur shënimi te emri i kandidatit;
 - Kërkojnë konstatimin e pavlefshmërisë së vendimit të KQZ-së ku është emëruar sekretari i KZAZ-së nr. 64, Kuçovë, z. Romeo Arizi pasi ky shtetas nuk plotëson kushtin e të qenit jurist;
 - Kërkojnë pavlefshmërinë e vendimit të KZAZ nr. 64 Kuçovë për ndërprerjen e numërimit të votave nga ora 11:00 deri në orën 12:30.

7. Subjektet ankuese paraqitën kërkesa për:

- vënien në dispozicion të të gjitha regjistrimeve video të kamerave të procesit të numërimit në ZAZ-në nr. 64;
- administrimin nga KAS të Librit të Protokollit të Mbledhjeve, procesverbalet e konstatimit të KZAZ-së nr. 64, tabelat e rezultatit të grupeve të numërimit për QV-të e cituara në ankim në cilësinë e provës si dhe çdo dokument tjetër të nevojshëm për një hetim administrativ të plotë dhe të paanshëm.

Kërkesat për vënien në dispozicion të regjistrimeve të kamerave vëzhguese u plotësuan nga administrata e KQZ-së, për aq sa ishte e mundur, jashtë procedurës së shqyrtimit të ankimit. KAS-i i dha ankuesve kohën e nevojshme, me qëllim që të këqyrnin regjistrimet video dhe të qëmtonin tek to provat në mbështetje të kërkesave ankimore.

8. Kërkesat ankimore nr. 67, datë 20.05.2023 dhe nr. 74, datë 22.05.2023 iu paraqitën KAS-it, i cili në seancë paraprake vendosi pranimin për shqyrtim të kërkesës ankimore nr.67, datë 20.05.2023, pranimin pjesërisht për shqyrtim të kërkesës ankimore nr. 74, datë 22.05.2023, të paraqitur nga z. Lefter Maliqi, si dhe shqyrtimin e dy kërkesave ankimore bashkërisht me relator z. Koli Bele. KAS-i caktoi seancën e shqyrtimit më datë 01.06.2023, ora 13:30. Në seancë ishin të pranishëm administrata e KQZ-së, përfaqësuar nga Sekretari i Përgjithshëm z. Ylli Merkaj; përfaqësuesit e palëve ankimuese, z. Altin Kaziaj për koalicionin “Bashkë Fitojmë”, dhe avokatët Arben Llangozi dhe Orgesa Serani për z. Lefter Maliqi; si dhe përfaqësuesi i palës së interesuar “Partia Socialiste e Shqipërisë”, z. Maringlen Legisi. Duke qenë se në këtë proces, pretendimet dhe argumentat e ankuesve ishin të ngjashme, por debati u zhvillua vetëm me pjesëmarrjen aktive të përfaqësuesve të ankuesit 2, analiza e këtij vendimi do t’i referohet kryesisht ankuesit 2 dhe pretendimeve të ngritura prej tij, duke nënkuptuar, se arsyetimi i jep përgjigje njëkohësisht edhe pretendimeve të ngritura nga ankuesi 1.
9. Në datën 07.06.2023 Kolegji Zgjedhor Gjyqësor vendosi shfuqizimin e pikës 2 të Vendimit nr. 136, datë 24.05.2023 të Komisionit të Ankimeve dhe Sanksioneve, me të cilin KAS-i kishte

vendosur rrëzimin për mungesë kompetence të disa prej kërkimeve të ankuesit Lefter Maliqi dhe detyrimin e Komisionit të Ankimeve dhe Sanksioneve të bëjë pjese të shqyrtimit, kërkimet e rrëzuara për shkak të mungesës së kompetencës të kërkesës ankimore nr.74, datë 22.05.2023, të ankuesit Lefter Maliqi, në kuadër të shkaqeve të pavlefshmërisë së zgjedhjeve.

10. Përfaqësuesit e z. Maliqi paraqitën gjatë shqyrtimit në seancë këto kërkesa dhe pretendime:

- Kërkesën për revokimin e pikës 2 të vendimit nr. 136, datë 24.05.2023 të KAS “Për pranimin për shqyrtim të kërkesës ankimore nr. 74, datë 22.05.2023 të depozituar nga z. Lefter Maliqi”;
- Kërkesën për pezullimin e shqyrtimit për shkak të kërkesëpadisë drejtuar Kolegjit Zgjedhor Gjyqësor në datën 29.05.2023 nga avokatët e z. Maliqi;
- Kërkesën për sekuestrimin e materialeve zgjedhore si masë provizore, bazuar në nenin 67 të Kodit të Procedurave Administrative;
- Kërkesën për marrjen në cilësinë e dëshmitarit z. Kreshnik Hajdari dhe z. Petrit Salillari;
- Kërkesën që KAS t’i drejtohet Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit e cila ka akses në sistemin TIMS, për të marrë të dhëna për 45 qytetarë të cilët nuk kanë qenë në Shqipëri ditën e votimit, por ankuesi pretendon se këta shtetas kanë votuar;
- Kërkesën për rinumërimin dhe rivlerësimin e të gjitha votave të hedhura në kuti për kandidatët për kryetar bashkie në bashkinë Kuçovë;
- Kërkesën për përjashtimin e gjithë trupës së anëtarëve të KAS.

10. KAS-i mori në shqyrtim dhe administroi:

- Kërkesën ankimore nr. 67, datë 20.05.2023;
- Kërkesën ankimore nr.74, datë 22.05.2023;
- Vendimin nr. 101, datë 16.05.2023 të KZAZ nr.64;

- Librin e Protokollit të KZAZ-së nr. 64;
- Vendimin e dënimit nga gjykata Greke e z. Kreshnik Hajdari, përkthyer në shqip;
- Formularin e vetëdeklarimit të z. Kreshnik Hajdari, depozituar në KQZ në datë 26.03.2023;
- Akt ekspertimi nr. 48, datë 21.05.2023 “Ekspertim Grafik Nnëshkrimi”;
- Kërkesa datë 26.05.2023 drejtuar Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve për të marrë informacion nga sistemi TIMS për shtetasin Lavdimir Tomorri nëse ndodhej në Shqipëri në datën 14 maj 2023;
- Kërkesa nr. 02/02 prot., datë 12.06.2023 për pezullimin e ankimit deri në gjykimin e çështjes nga Kolegji Zgjedhor;
- Shkresën e Sekretarit të Përgjithshëm të KQZ, nr. 6021 prot., datë 15.06.2023;
- Procesverbal MOD-07 i QV-së nr. 3517/01, bashkia Kuçovë
- Hard disc dorëzuar nga pala ankimuese me pamje filmike/video.

Në përfundim të shqyrtimit administrativ dhe të vlerësimit të provave dhe pretendimeve përfundimtare,

KAS-i konstaton:

- I. **Lidhur me objektin e kërkesës ankimore dhe urdhërimin e KZGJ-së për të hetuar kërkimet jashtë kompetence në kuadër të shkaqeve të pavlefshmërisë së zgjedhjeve**
 1. Me kërkesën ankimore nr 74, subjekti zgjedhor Lefter Maliqi, kandidat i koalicionit “Bashkë Fitojmë” për kryetar bashkie, bashkia Kuçovë ka kërkuar të vërë në lëvizje KAS-in, duke i kërkuar:
 - (1) Ndryshimin e vendimit nr. 101, datë 16.06.2023 të ZAZ-së nr. 64, bashkia Kuçovë, qarku Berat “Për miratimin e tabelës përmbledhëse të rezultateve për zgjedhjen e kryetarit të bashkisë Kuçovë”.

- (2) Rinumërim dhe rivlerësim i votave për ZAZ-në nr. 64, të gjitha QV-të, duke përfshirë në të rezultatin e dalë nga rinumërimi dhe rivlerësimi i votave për QV-të e listuara në tabelë.
 - (3) Pavlefshmëri e vendimit nr. 101, datë 16.05.2023 "Për miratimin e tabelës përmbledhëse të rezultateve për zgjedhjen e kryetarit të bashkisë Kuçovë".
 - (4) Konstatim i pavlefshmërisë së vendimit të KQZ-së ku është emëruar sekretari i KZAZ-së nr. 64 Kuçovë, shtetasi Romeo Arizi.
 - (5) Pavlefshmëri e vendimit të KZAZ-së nr. 64 Kuçovë, qarku Berat, për shtyrjen e numërimit të votës, nga ora 10:00 deri në orën 12:30.
 - (6) Pavlefshmëri e pjesëshme e fletës së votimit Kandidatët për Kryetar Bashkie për Bashkinë Kuçovë, në pikën ku është shënuar kandidati për bashkinë Kuçovë, qarku Berat, kreshnik Hajdari.
 - (7) Pavlefshmëri e veprimit juridik, formulari i dekriminalizimit, në emër të kreshnik Hajdarit dorëzuar pranë KQZ referuar ligjit nr. 138/2015 "Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike".
2. Kodi Zgjedhor përcakton se procedura e shqyrtimit të ankesave në KAS kalon domosdoshmërisht në dy faza, në fazën e verifikimit paraprak dhe në fazën e shqyrtimit në themel. Në fazën e verifikimit paraprak KAS-i shqyrton kompetencën e KQZ-së për shqyrtimin e ankimit, legjitimitimin e ankuesit dhe respektimin e afateve ligjore për ankimin (neni 130 i Kodit Zgjedhor). **KAS-i mund të shqyrtojë vetëm çështje që i përkasin kompetencës së tij, të ngritura nga palë që kanë një interes të ligjshëm dhe kur ato janë depozituar brenda afatit ligjor përkatës.** Verifikimi paraprak përmbyllet me vendimin për pranimin dhe kalimin për shqyrtim të kërkesës ankimore, ose me vendimin për moskalimin për shqyrtim të saj. Vendimi i parë është vendim i ndërmjetëm. Ai cakton datën dhe orën e shqyrtimit të çështjes në themel, ka fuqi deri në këtë datë dhe orë dhe është i pa ankimueshëm. Vendimi i dytë është përfundimtar, për pasojë, i ankimueshëm. Vendimi i KAS-it nr. 136, datë 24.05.2023 ka rënë nga fuqia në datën 26.05.2023, ora 11:30.

3. Në praktikën e KAS-it, vendimet e ndërmjetme arsyetohen bashkë me vendimin përfundimtar, për shkak se ankimohen bashkë me të. Vendimet e ndërmjetme janë vendime të brendshme që i shërbejnë menaxhimit të seancës dhe/ose të debatit rreth çështjes objekt shqyrtimi. Vendimmarrja për kompetencën, legjitimitetin dhe afatin i përket seancës paraprake, për shkak se Kodi Zgjedhor ia ka ndarë këtë detyrë KAS-it që t'a shqyrtojë dhe t'a vendosë në seancën paraprake. Refuzimi nga ana e KAS-it i një kërkitimi të veçantë nga tërësia e objektit, nuk e shndërron vendimin në vendim përfundimtar, sa kohë që KAS-i ka pranuar për shqyrtim kërkimet e tjera të objektit të kërkesës ankimore. Refuzimi në tërësi i kërkesës ankimore, me të gjitha kërkimet e veçanta që përmbahen në të, është vendim përfundimtar, sepse KAS-i deklaron me këtë vendim vullnetin e tij përfundimtar në raport me kërkesën ankimore në tërësi dhe mbylljen e shqyrtimit.
4. Kolegji Zgjedhor Gjyqësor, me vendimin datë 07.06.2023 pranoi ankimin e ankuesit Lefter Maliqi dhe ankimin e subjektit zgjedhor "Bashkë Fitojmë" kundër vendimit nr. 136, datë 24.05.2023, si dhe vendosi "shfuqizimin e pikës 2 të Vendimit nr.136, datë 24.05.2023 të Komisionit të Ankimeve dhe Sanksioneve" dhe "detyrimin e Komisionit të Ankimeve dhe Sanksioneve të bëjë pjesë të shqyrtimit, kërkimet e rrëzuara për shkak të mungesës së kompetencës të kërkesës ankimore nr.74, datë 22.05.2023, të ankuesit Lefter Maliqi, **në kuadër të shkaqeve të pavlefshmërisë së zgjedhjeve**".
5. Vendimi i mësipërm i KZGJ-së nuk është bërë publik dhe as palët, as KAS-i nuk janë vënë në dijeni të arsyetimit të KZGJ-së, por, në lexim të pjesës urdhëruese, KAS-i konstaton, se **ankuesi nuk kishte kërkuar "pavlefshmërinë e zgjedhjeve"**, as në momentin e depozitimit të kërkesës ankimore, as në momentin e depozitimit të padisë në KZGJ dhe as në momentin e paraqitjes së pretendimeve përfundimtare përpara KAS-it. Urdhërimi i KZGJ-së, që KAS-i "t'i bëjë pjesë të shqyrtimit... (këto kërkitime) .. **në kuadër të shkaqeve të pavlefshmërisë së zgjedhjeve**" do të thotë për KAS-in, se ato duhet të mbahen në konsideratë në rastin se KAS-i dallon shkaqe për shpalljen *ex officio* të pavlefshmërisë së zgjedhjeve, në zbatim të pikës 2 të nenit 143 të Kodit Zgjedhor, e cila i njeh KAS-it kompetencën që të marrë vendim, sipas njërit nga rastet e parashikuara në pikën 1 të këtij neni, **pavarësisht nga ajo çfarë ankuesi ka kërkuar në ankimin e tij.** (shkronja "ç" e pikës 1 - "në përfundim të shqyrtimit të ankimit KQZ-ja vendos sipas

rastit...shpalljen e zgjedhjeve të pavlefshme në një ose disa qendra votimi të zonës zgjedhore ose në të gjithë njësinë zgjedhore”).

6. Pavarësisht se pika 2 e vendimit të KAS-it nr. 136, datë 24.05.2023 është shfuqizuar nga KZGJ-ja, KAS-i duhet të konstatojë dhe të arsyetojë, gjithësesi, mungesën e kompetencës për kërkimet e veçanta që përfshihen në objektin e kërkesës ankimore.
7. KAS-i është organ i KQZ-së, i cili ka kompetencë shqyrtimin e ankimeve administrative ndaj vendimeve të KZAZ-ve dhe ndaj vendimeve të Komisionerit (pika 5 e nenit 12, pika 1 e nenit 21 të Kodit Zgjedhor). Subjektet zgjedhore, nga ana tjetër, gëzojnë të drejtën e posaçme të ankimit në KAS **kundër vendimit të KZAZ-së ose të Komisionerit për shpalljen e rezultatit për zgjedhjet e organeve të njërive të qeverisjes vendore të juridiksionit të tyre** (pikat 2 dhe 3 të nenit 124 të Kodit Zgjedhor). Ankimi ndaj këtij vendimi, përcaktojnë si pika 2, ashtu dhe pika 3 e nenit 124, **mund të përmbajë ndryshimin e Tabelës Përmbledhëse të Rezultatit të Zonës Zgjedhore ose/dhe pavlefshmërinë e rezultatit në një apo disa qendra votimi**. Neni 124 ka përcaktuar qartë objektin e ankimit, kur subjektet kundërshtojnë shpalljen e rezultatit.
8. Duke shfrytëzuar këtë bazë ligjore (nenin 124), ankuesi ka vënë në lëvizje KAS-in me kërkesën ankimore nr. 74. Në përputhje me nenin 124, ankuesi ka kërkuar “ndryshimin e vendimit nr. 101, datë 16.06.2023 të ZAZ-së nr. 64, bashkia Kuçovë, qarku Berat “Për miratimin e tabelës përmbledhëse të rezultateve për zgjedhjen e kryetarit të bashkisë Kuçovë”, **por jo pavlefshmërinë e rezultatit në një ose disa qendra votimi**. Kërkesa për “pavlefshmërinë e vendimit nr. 101, datë 16.05.2023 “Për miratimin e tabelës përmbledhëse të rezultateve për zgjedhjen e kryetarit të bashkisë Kuçovë”(pika 3 e objektit të kërkesës ankimore), e cila bie në kundërshtim dhe është e papajtueshme me pikën 1 të të njejtit objekt (me kërkesën për “ndryshimin e vendimit nr. 101, datë 16.06.2023 të ZAZ-së nr. 64”) u konsideruar lapsus gjatë seancës paraprake nga ankuesi, i cili dha sqarimin se qëllimi ishte të kërkohej pavlefshmëri rezultati. KAS-i orientoi ankuesin drejt saktësimit të kësaj kërkesë, sepse për të njejtën QV nuk mund të kërkohej dhe ndryshim i rezultatit dhe pavlefshmëri e tij. Kërkesat nuk mund të jenë konkurruese me njera tjetrë. Ato janë alternativa të njera tjetrës.

9. Ankuesi nuk e ndoqi këtë sugjerim të KAS-it deri në fund të shqyrtimit të ankimit. Në pretendimet përfundimtare, ankuesi i qëndroi kërkimin për “pavlefshmërinë e vendimit nr. 101, datë 16.05.2023 “Për miratimin e tabelës përmbledhëse të rezultateve për zgjedhjen e kryetarit të bashkisë Kuçovë” (faqja 1 dhe faqja 18 e dokumentit të titulluar “Konkluzione” dhe që mban nr.02/02. prot., datë 06.12.2023 (sic.)). Ankuesi hoqi dorë në seancë nga kërkitimi për pikën 4 të objektit të kërkesës ankimore, nga kërkesa për “konstatimin e pavlefshmërisë së vendimit të KQZ-së ku është emëruar sekretari i KZAZ-së nr. 64 Kuçovë, shtetasi Romeo Arizi. Në këto kushte, KAS-i nuk do të përfshijë në këtë vendim analizën për vendimin nr 163, datë 10.03.2023 “Për emërimin e anëtarëve dhe sekretarëve të komisioneve të zonave të administrimit zgjedhor, të propozuar nga Partia Demokratike, për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 14 maj 2023”, me të cilin është emëruar në detyrë sekretari i KZAZ-së nr. 64, z. Romeo Harizi.
10. Ankuesi ka përfshirë në objektin e kërkesës ankimore “rinumërimin dhe rivlerësimin e votave për ZAZ-në nr. 64, të gjitha QV-të, duke përfshirë në të rezultatin e dalë nga rinumërimi dhe rivlerësimi i votave për QV-të e listuara në tabelë” (pika 2 e objektit të kërkesës). Rinumërimi dhe/ose rivlerësimi i votave nuk mund të jetë objekt kërkitimi. Në Kodin Zgjedhor të vitit 2000 (Ligji nr. 8609, datë 08.05.2000) ka qenë njohur e drejta e subjekteve zgjedhore për të kërkuar nga KQZ-ja rinumërim dhe rivlerësim të votave jashtë procedurës ankimore dhe në rrethana specifike (për diferenca të ngushta votash). Kjo prerogativë, e pranuar edhe nga ligji nr. 9087, datë 19.6.2003 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë), u është hequr subjekteve zgjedhore me Kodin Zgjedhor të vitit 2008 (ligji 10019, datë 29.12.2008). **Kodi Zgjedhor në fuqi e njeh rinumërimin dhe/ose rivlerësimin vetëm si mjet për marrjen dhe këqyrjen e provës.** Kjo do të thotë se pika 2 e objektit nuk ka bazë ligjore.

(Ligji nr. 8609, datë 08.05.2000 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”- i shfuqizuar)

KREU VIII

RINUMËRIMI I FLETËVE TË VOTIMIT

Neni 108

Kriteret e rinumërimin të fletëve të votimit

Nëse, pasi KZQV-ja ose KZZ-ja ka shpallur zgjedhjen e një personi (me përjashtim të kandidatëve të listave shumemërore), rezulton se diferenca mes votave të fituesit dhe kandidatit që ka dalë i dyti është më e vogël se numri i përgjithshëm i votave të shpallura të pavlefshme gjatë numërimit ose nëse diferenca e mësipërme është jo më shumë se 25 vota, fletët e votimit rinumërohen në mënyrën e përcaktuar në këtë kre.

Nëse, pasi KZQV-ja ose KZZ-ja ka shpallur zgjedhjen e një personi (me përjashtim të kandidatëve të listave shumemërore), rezulton se diferenca e më sipërme është jo më shumë se 150 vota dhe jo më e madhe se numri i përgjithshëm i votave të shpallura të pavlefshme gjatë numërimit, KZQV-ja ose KZZ-ja, me kërkesën e kandidatit që ka dalë i dyti, organizon rinumërimin e votave si vijon:

Kërkesa bëhet në formën e caktuar nga KQZ-ja dhe nënshkruhet nga kandidati dhe përfaqësuesi i tij zyrtar.

Kërkesa për rinumërim i dorëzohet kryetarit të komisionit përkatës jo më vonë se ora 16:00 e ditës së dytë pas numërimit përfundimtar të votave nga KZQV-ja ose KZZ-ja.

Me marrjen e kërkesës për rinumërim, KZQV-ja ose KZZ-ja organizon rinumërimin e votave, i cili duhet të fillojë jo më vonë se 48 orë pas marrjes së kërkesës.

Në rastet kur kërkohet rinumërimi i votave sipas pikave 1 dhe 2 të këtij neni, kryetari i komisionit njofton menjëherë kryetarin e gjykatës së rrethit, i cili organizon zgjedhjen me short të tre gjyqtarëve të kësaj gjykate për të bërë rinumërimin e votave brenda afatit të caktuar në këtë Kod.

Shpenzimet që lidhen me rinumërimin e votave mbulohen nga KQZ-ja.

(Ligji nr. 9087, datë 19.6.2003 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”- i shfuqizuar)

KREU VI

RINUMËRIMI I FLETËVE TË VOTIMIT

Neni 111

Kriteret e rinumërimit të fletëve të votimit

1. Brenda 24 orëve nga shpallja e rezultatit të zgjedhjeve në njësinë zgjedhore, subjektet e interesuara kanë të drejtë të kërkojnë rinumërimin e votave për kandidatët për deputet ose kryetar bashkie a komune, në rast se diferenca mes votave të kandidatit që ka dalë i pari dhe kandidatit që ka dalë i dyti është më e vogël se numri i votave të pavlefshme gjatë numërimit, ose nëse diferenca e mësipërme është jo më shumë se 150 vota. Kërkesa i dorëzohet kryetarit, zëvendëskryetarit ose sekretarit të KZQV-së ose KZZ-së .

2. KZZ-ja ose KZQV-ja organizon dhe fillon rinumërimin e fletëve të votimit brenda 24 orëve nga shpallja e vendimit për rinumërim.

11. Rinumërimi dhe rivlerësimi i votave është një proces administrativ që nuk çon dot në zbulimin e shkaqeve për pavlefshmërinë e zgjedhjeve. Fokus i këtij procesi janë vetëm fletët e votimit dhe leximi i vullnetit të shprehur në to. Nga leximi i votës nuk mund të dilet në konkluzione për mënyrën se si është hedhur vota në kuti, për faktin nëse vullneti i shprehur në të ka qenë i kondicionuar apo është deformuar, për faktin nëse ka pasur përjashtim masiv nga e drejta e votimit, apo për faktin nëse zgjedhësit janë penguar masivisht që të ushtrojnë të drejtën e tyre. Të gjitha këto shfaqje, që mund të përbëjnë shkaqe për të vendosur pavlefshmërinë e zgjedhjeve, nuk mund të hetohen nëpërmjet numërimit dhe vlerësimit të votave. Në këto kushte, KAS-i është i detyruar të dalë në konkluzionin, se tek ky kërkim sipas objekti të kërkesës ankimore, nuk ka hapësirë për të hetuar shkaqe pavlefshmërie zgjedhjes, sikurse kërkon KZGJ-ja me vendimin datë 07.06.2023.

12. Kodi i Procedurave Administrative përcakton në pikën 2 të nenit 110 se *“pavlefshmëria absolute e aktit mund të konstatohet në çdo kohë, kryesisht apo me kërkesë, të çdo të interesuari, nga organi publik që e ka nxjerrë atë, organi epror i tij apo organi që është kompetent të shqyrtojë mjetet ligjore administrative, si dhe nga gjykata kompetente për çështjet administrative, sipas ligjit”*. Për vendimin nr. 101, datë 16.05.2023 *“Për miratimin e tabelës përmbledhëse të rezultateve për zgjedhjen e kryetarit të bashkisë Kuçovë”* (pika 3 e objektit të kërkesës ankimore) organi publik që ka nxjerrë aktin është KZAZ-ja bashkia Kuçovë. Për vendimin e KZAZ-së nr. 64 Kuçovë, qarku Berat, referuar pa numër dhe pa datë nga ankuesi (pika 5 e objektit të kërkesës

ankimore), me të cilin është vendosur shtyrja e numërimit të votës, nga ora 10:00 deri në orën 12:30, organi që ka nxjerrë aktin është, sikurse referohet, po kështu vetë KZAZ-ja. Për vendimin nr. 363, datë 15.04.2023 "Për miratimin e përmbajtjes së fletës së votimit për kandidatët për kryetar bashkie në 60 bashki, për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 14 maj 2023", me të cilin është miratuar fleta e votimit për kandidatët për kryetar bashkie për bashkinë Kuçovë (pika 6 e objektit të kërkesës ankimore) organi që ka nxjerrë aktin është Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve. Për këto akte, neni 110 i KPrA përcakton kompetencën e organit publik që ka nxjerrë aktin administrativ për shqyrtimin e kërkesave për konstatimin e pavlefshmërisë absolute të këtyre akteve.

13. KZAZ-ja nr. 64, si çdo komision tjetër zgjedhor, është trupë e posaçme, e cila ngrihet dhe funksionon sipas rregullave specifike, me kohë të pjesëshme dhe me kompozim politik. Anëtarët e komisioneve janë zyrtarë zgjedhorë, por jo zyrtarë shtetërorë. Ata nuk gëzojnë statusin e nëpunësit civil, por emërohen në detyrë nga Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve. Për shkakun se Komisioneri është organi i emërtesës, ai mund të quhet organi epror i tyre, në kuptimin e dispozitës së nenit 110 të KPrA. Kjo do të thotë se, nëse ankuesi kërkon të vejë në lëvizje organin epror për të kërkuar pavlefshmërinë e akteve të KZAZ-së nr. 64, atëherë organin epror do ta gjejë tek Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve. Komisioneri, nga ana e tij është organ drejtues i KQZ-së (pika 2 e nenit 12 të Kodit Zgjedhor), organ drejtues i një institucioni të pavarur. Komisioneri nuk ka organ epror, në kuptimin e nenit 110 të KPrA.
14. KAS-i është "organ kompetent për shqyrtimin e mjeteve ligjore administrative", në kuptimin e nenit 110 të KPrA. Vendimet e KZAZ-ve dhe të Komisionerit ankohen në KAS, brenda afateve të përcaktuara në Kod. Nga dalja e dekretit të Presidentit të Republikës për shpalljen e zgjedhjeve të datës 14 maj 2023 afati i ankimit në KAS ndaj akteve të KZAZ-ve dhe të Komisionerit është 3 ditë (ndaj vendimit për shpalljen e rezultatit të zgjedhjeve, 5 ditë). Afati i ankimit në KAS për pikën 3 të objektit të kërkesës ankimore ka mbaruar në datën 21.05.2023, për pikën 5 ka mbaruar në harkun e tre ditëve nga data e marrjes së vendimit dhe për pikën 6 ka mbaruar në datën 18.04.2023. E drejta e ankuesit për të vënë në lëvizje KAS-in me ankime për këto akte administrative ka rënë në dekadencë. Afatet janë ezauruar dhe kërkesa për pavlefshmërinë e

akteve nuk mund të parashtrohet në rrugën e ankimimit administrativ. Prandaj KAS-i nuk është kompetent për konstatimin e pavlefshmërisë së akteve.

15. Pika 7 e objektit të kërkesës ankimore, nga përmbajtja duket se është lëndë që i përket të drejtës penale dhe kompetencës lëndore të organeve të ndjekjes penale. Terminologjia e zgjedhur nga ana e ankuesit i përket fushës së të drejtës civile (veprim juridik, etj.). Veprimi juridik shpjegohet në legjislacionin shqiptar nga Kodi Civil. Neni 79 i tij përcakton se “veprimi juridik është shfaqja e ligjshme e vullnetit të personit fizik ose juridik, që synon të krijojë, të ndryshojë ose të shuajë të drejta ose detyrime civile”. E drejta administrative, që është fusha ku vepron KAS-i, merret me aktet administrative dhe marrëdhëniet që krijojnë, modifikojnë ose shuajnë ato. E drejta administrative njeh, gjithashtu, konceptin e pavlefshmërisë së akteve administrative. “Formulari i dekriminalizimit” që përmendet në këtë pikë nuk është akt administrativ dhe nuk nxirret nga ndonjë organ publik. Ai është dokument që plotësohet nga individët, nën përgjegjësinë e tyre personale dhe penale. Pika 7 e objektit të kërkesës ankimore nuk përfshihet dot brenda kompetencës së KAS-it.
16. Ankuesi nuk paraqiti ndonjë analizë rreth pretendimit për pavlefshmëri akti në kërkesën ankimore, gjatë debatit në seancë dhe në dokumentin final “Konkluzione”, si për vendimin e KZAZ-së nr. 101, ashtu dhe për vendimin për shtyrjen e orarit për fillimin e numërimit të votave. Neni 108 i KPrA përcakton sa vijon:

Neni 108

Akti administrativ absolutisht i pavlefshëm

Akti administrativ është absolutisht i pavlefshëm në rastet e mëposhtme:

- a) kur vjen në kundërshtim të hapur dhe flagrant me një dispozitë urdhëruese të këtij Kodi dhe legjislacionit në fuqi lidhur me:*
 - ii) kompetencën e organit publik;*
 - iii) procedurën e nxjerrjes së tij; ose*

- iv) formën ose elementë të tjerë të detyrueshëm të aktit;*
- e) është nxjerrë nëpërmjet mashtrimit, kanosjes, mitmarrjes, konfliktit të interesit, falsifikimit apo një veprimi tjetër që përbën vepër penale;*
- f) ekzekutimi i aktit mund të shkaktojë një veprim të dënueshëm, sipas legjislacionit penal;*
- ç) në çdo rast tjetër të parashikuar shprehimisht në ligj.*

Pyetja që shtrohet është: “cili është shkaku ligjor, për të cilin kërkohet pavlefshmëria absolute e aktit?”. **Ankuesi nuk ka dhënë asnjë shpjegim për këtë pyetje.** KAS-i e ka të pamundur të arsyetojë rreth çështjes, nëse shkaku i pretenduar për pavlefshëmrinë e aktit mund të përbëjë shkak për pavlefshëmrinë e zgjedhjeve, sikurse i kërkon KZGJ-ja me dispozitivin e vendimit të saj të datës 07.06.2023, sepse KAS-i nuk mund të identifikojë një shkak të mundshëm pavlefshmërie për aktin, as nga shpjegimet e ankuesit, as kryesisht.

17. Ankuesi pretendoi në seancë se vendimi i KZAZ-së për shtyrjen e numërimit, i cili u mor papritur, me rrëmbim dhe pa justifikim, ngre dyshime të forta se ka qenë i motivuar nga qëllimi për të ndërhyrë tek kutitë, për të manipuluar votat brenda në kuti dhe për modifikuar rezultatin. Ankuesi pretendoi se një grup kutish (rreth 18 prej tyre), ato që ndodheshin pranë derës së kthinës së VNV-së dhe jashtë rrezes së shikimit të kamerës vëzhguese, kanë pësuar ndërhyrje dhe manipulim, sepse rezultati i tyre nuk justifikohet me pritshmëritë dhe historikun e votimit.
18. Ankuesi e mbështeti pretendimin me një provë video të marrë nga një rrjet televiziv privat, në të cilën paraqitet intervista e një personi të pidentifikuar dhe të pidentifikueshëm, i cili “rrëfente”, se me urdhër nga drejtuesit e KZAZ-së kishte ndërhyrë tek kutitë dhe kishte hequr nga kutitë “procesverbalet origjinalë të mbylljes së kutive”. Materiali video tregon një numër procesverbalesh MOD-07 dhe MOD-08. Si provë e dytë u paraqit foto e derës anësore që lidhte me kthinën e VNV-së dhe që ka qenë e mbyllur, por e pasiguruar gjatë kohës që ka qenë në përdorim VNV-ja. Provë e tretë u paraqit pamja e përgjithshme e VNV-së, siç mbulohet nga kamera vëzhguese. KAS-i e hetoi në tërësi pretendimin, duke nisur me gjurmimin e procesverbalit të shfaqur në pamjet e intervistës televizive.

19. Nga analiza në tërësi e fakteve, KAS-i doli në konkluzionin se intervista e paraqitur si provë ka të gjitha ingredientët e një ngjarjeje të fabrikuar dhe dyshimi i ngritur bazuar në të nuk mund të jetë veçse i pavërtetë, për një sërë arsyesh:

- Ngjarja e “referuar” nga i intervistuari, nëse do ishte e vërtetë do të kish lënë gjurmë dhe do të ishte faktuar nga prishja e kodeve të sigurisë të kutive. Çdo kuti që ka kodet e prishura apo të ndërruara nuk mund të hapet dhe t’i nënshtrohet numërimit. Të gjitha kutitë e kësaj ZAZ-je janë konsideruar të rregullta, janë hapur dhe janë numëruar, pa asnjë konstatim, vërejtje apo kontestim lidhur me kodet e sigurisë. Pesë grupe të ndryshme numërimi kanë administruar kutitë dhe asnjëri nuk ka konstatuar asnjë parregullsi. Ky fakt konfirmohet nga libri i protokollit i KZAZ-së, i cili duhet të kishte doemos shënimet përkatëse nëse konstatoheshin mospërputhje midis kodeve të sigurisë dhe të dhënave të procesverbalëve, si dhe duhet të kishte të pasqyruara edhe vendimet për deklarimin e kutive të parregullta.
- Së dyti, hetimi i KAS-it, bazuar në të dhënën e vetme me vlerë provuese nga “intervista”, në kodet e sigurisë të procesverbalit që shfaqet për një moment në video, konkludoi se procesverbali me kodet e sigurisë që shfaqet në video është administruar edhe nga GNV-ja në hapjen dhe numërimin e kësaj kutie. Nëse procesverbali dhe kodet janë të njejta, atëherë kjo do të thotë se kutia nuk është çenuar, kodet nuk janë prishur dhe procesverbali nuk është nxjerrë nga kutia. Kjo do të thotë, se “rrëfimi” është i pavërtetë dhe i fabrikuar.
- Së treti, procedura e administrimit të kodeve përcakton, se procesverbalet e mbylljes së kutive u jepen si dokument provues secilit anëtar të KQV-së. Sikurse u shpjegua nga administrata e KQZ-së, dokumenti origjinal i procesverbalit përbëhet nga një fletë formulari, e printuar me ngjyra dhe që përmban 3 kopje kimike, e cila plotësohet me stilolaps nga sekretari dhe nënshkruhet nga anëtarët. Origjinali hidhet në kutinë e votave për kryetarin dhe një kopje kimike hidhet në kutinë e votave për këshillin bashkiak. Kopjet e dokumentit, që u shpërndahen anëtarëve janë identike në format, ngjyrë dhe përbërje me origjinalin që hidhet në kuti, por nuk shoqërohen me kopje kimike. Edhe këto të fundit plotësohen nga sekretari dhe nënshkruhen nga anëtarët. Procesverbali nuk është kopje unike dhe nuk gjendet vetëm në kuti, por secili anëtar ka kopjen e tij. Procesverbali i filmuar në video nuk mund të ketë

qenë procesverbali i futur në kuti, por mund të ketë qenë kopja e secilit prej anëtarëve të komisionit.

- Së katërti, të gjitha kutitë e ZAZ-së kanë qenë gjatë gjithë kohës në syrin e kameras vëzhguese, e cila ka rregjistruar pa pushim. Imazhi i regjistrimit ka qenë i qartë, i fokusuar dhe i plotë, gjë që u verifikua edhe nga KAS-i, në bazë të provës së paraqitur nga ankuesi. Materiali i regjistrimit video ka qenë në dispozicion dhe është këqyrur nga ankuesi. Ankuesi nuk i solli asnjë pamje KAS-it, ku të provohej ndërhyrje apo çfarëdolloj lëvizje e dyshimtë pranë ose rreth kutive.
- Së pesti, koha kur ankuesi lidh dyshimin e tij për hapje dhe manipulim të kutive i përket momentit kur KZAZ-ja vendosi shtyrjen për rreth një orë të procedurës për fillimin e numërimit. Në këto momente mjediset e VNV-së kanë qenë të mbyllura e të siguruara, brenda tyre nuk ka pasur njerëz (gjë që konfirmohet edhe nga regjistrimet e kameras vëzhguese), ndërsa jashtë mjedisit ka qenë një grumbull i madh personash (rreth 500 veta, sipas pohimit të kandidatit Lefter Maliqi). Mundësia për të organizuar një aksion blic për rrëmbimin e procesverbaleve, pa u diktuar nga askush përreth dhe pa u vëzhguar nga kamera është zero.
- Së fundi, I intervistuari flet për hapje të kutive, me qëllimin për të nxjerrë prej aty procesverbalet e mbylljes së kutive, por nuk flet për ndërhyrje në fletët e votimit!!! Sipas ‘dëshmisë’ së tij, qëllimi kanë qenë procesverbalet e mbylljes, jo manipulimi i fletëve në kuti. Urdhëri nga “eprorët” ishte dhënë vetëm për procesverbalet!!! Po fletët? Apo për to kishte grupe të tjera që do të kryenin një aksion të dytë?!!! Nëse nuk kishte një “aksion” të dytë për të ndërhyrë tek fletët e votimit, atëherë ç’kuptim kishte “aksioni” i parë?!!! “Rrëfimi” është i stisur dhe jo llogjik.

20. Ankuesi paraqiti si provë një procesverbal tjetër “original”, i cili përmbante të njejtat të dhëna me procesverbalin e shfaqur në video dhe procesverbalin e dosjes së KZAZ-së të administruar në seancë. Qëllimi i ankuesit ishte që të provonte, se nuk mund të ketë dy procesverbale “origjinale” dhe, sa kohë që “originali” po paraqitej prej tij si provë, atëherë në KZAZ-së nuk mund të jetë depozituar procesverbali origjinal. Nga këqyrja e provës, KAS-i konstatoi se procesverbali i

paraqitur si provë nga ankuesi kishte një nënshkrim më pak, në dallim nga procesverbali i administruar nga dosja e KZAZ-së, nënshkrimin e anëtarit të komisionit, i cili ishte propozuar nga subjekti që mbështet ankuesin. Nga vëzhgimi me sy të lirë i dokumentit siç paraqitet në video me atë të paraqitur si provë nga ankuesi, KAS-i krijoi bindjen se procesverbali i videos dhe ai i depozituar nga ankuesi janë i njejtë dokument, me shumë gjasë, dokumenti i marrë ligjërisht nga anëtari i komisionit i propozuar nga subjekti që mbështet ankuesin, me të drejtën e tij për t'u pajisur me kopje të dokumentacionit.

21. Në përfundim të kësaj analize mbi provat dhe pretendimet, KAS-i arriti në konkluzionin se shqyrtimi i dy kërkimeve, i vendimit të KZAZ-së nr. 101 dhe i vendimit të KZAZ-së për shtyrjen e orarit për fillimin e numërimit të votave, me qëllimin për të zbuluar shkaqe për pavlefshmërinë e zgjedhjeve, sikurse urdhërohet nga KZGJ-ja me vendimin datë 07.06.2023, duhet të mbyllet me konkluzionin se të dy kërkimet nuk përmbajnë shkaqe për pavlefshmërinë e zgjedhjeve.
22. Lidhur me pikën 6 të objektit të kërkesës ankimore, shpjegimet e paraqitura nga ankuesi lënë të kuptohet se pretendimi i tij është që vendimi i Komisionerit nr. 363, datë 15.04.2023 "Për miratimin e përmbajtjes së fletës së votimit për kandidatët për kryetar bashkie në 60 bashki, për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 14 maj 2023", me të cilin është miratuar fleta e votimit për kandidatët për kryetar bashkie për bashkinë Kuçovë është akt absolutisht i pavlefshëm sa i takon kandidatit të subjektit zgjedhor "Partia Socialiste", sepse përfshirja e tij në fletën e votimit është bërë në kushtet e falsifikimit të formularit të vetëdeklarimit që kërkon neni 5 i ligjit nr.138/2015. Në këtë rast referenca ligjore për këtë pretendim do duhet të ishte shkronja "b" e nenit 108 të KPrA (Akti administrativ është absolutisht i pavlefshëm kur *"është nxjerrë nëpërmjet mashtrimit, kanosjes, mitmarrjes, konfliktit të interesit, falsifikimit apo një veprimi tjetër që përbën vepër penale"*).
23. Lidhur me këtë pretendim mund të bëhen këto konstatime:
 - i) Fleta e votimit përmban kandidatët e regjistruar në zgjedhje. Nëse kontestohet pjesëmarrja në zgjedhje e një kandidati, atëherë nuk atakohet fleta e votimit që është akt i derivuar, por

atakohet akti bazë, akti që e ka regjistruar atë në zgjedhje. Kandidati Kreshnik Hajdari është regjistruar në zgjedhje me vendim të KZAZ-së nr. 64 Kuçovë;

- ii) shkronja 'b' e nenit 108 të KPrA futet në veprim vetëm nëse paraprihet nga një vendim penal i formës së prerë, sepse i referohet ekskluzivisht shkaqeve që përbëjnë vepra penale. Për veprat penale zbatohet gjithmonë parimi *"kushdo quhet i pafajshëm përderisa nuk i është provuar fajësia me vendim gjyqësor të formës së prerë"* (neni 30 i kushtetutës së Republikës së Shqipërisë).
- iii) Procedura e regjistrimit të kandidatit të subjektit zgjedhor "Partia Socialiste", sa i takon vetëdeklarimit, ka qenë procedurë e rregullt dhe e kryer në përputhje të plotë me ligjin. KZAZ-ja ka pasur të drejtë të refuzonte regjistrimin e kandidatit, nëse ai do të refuzonte të depozitonte formularin e vetëdeklarimit, ose nuk do t'a bënte atë pjesë të dokumentave të veta të kandidimit (pika 2 e nenit 5 të ligjit nr. 138/2015). Deklarimi i rrethanave të rreme ose të shtrembëruara në formular përbën vepër penale, shkak për kallëzimin dhe procedimin e personit nga organet kompetente të ndjekjes penale. KZAZ-ja nuk është organ i tillë.
- iv) Sipas deklarimeve në seancë të përfaqësuesit ligjor të ankuesit, organi i ndjekjes penale ka marrë kallëzim për këtë subjekt, sikurse ka marrë kërkesë për verifikim të thelluar të vetëdeklarimit nga ana e Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve. Ankuesit i duhet të presë dhe të respektojë kompetencën ekskluzive të organit të prokurorisë në hetimin e kësaj çështjeje.

Në zbatim të urdhërimit të KZGJ-së edhe për këtë pikë, KAS-i del në konkluzionin, se nuk mund të ketë shkak për pavlefshmëri zgjedhjesh për një procedurë regjistrimi që është kryer në përputhje me ligjin.

II Lidhur me kërkimin për ndryshimin e vendimit nr. 101, datë 16.06.2023 të ZAZ-së nr. 64, bashkia Kuçovë, qarku Berat "Për miratimin e tabelës përmbledhëse të rezultateve për zgjedhjen e kryetarit të bashkisë Kuçovë"

1. Kërkimi për ndryshimin e vendimit për miratimin e tabelës përmbledhëse të rezultatit bëhet vetëm në rastet kur dokumentacioni zgjedhor dhe provat e administruara evidentojnë

mospërputhje midis shifrave të pasqyruara në tabelën përmbledhëse dhe të atyre të administruara nga provat. Ankuesi kishte në dispozicion mjete provuese të fuqishme, siç janë procesverbalet e konstatimit, tabelat e rezultateve të QV-ve, librin e protokollit të KZAZ-së dhe regjistrimet video për çdo votë të numëruar e të vlerësuar. Pavarësisht nga kjo, ai nuk i serviri KAS-it asnjë provë në mbështetje të kërkesës për ndryshimin e tabelës përmbledhëse të rezultatit.

2. Ankuesi ngriti vetëm një pretendim që mund të konsiderohet në kuadër të këtij kërkimi, pretendimin që rreth 1200 vota duhet të konsiderohen të pavlefshme, sepse atyre u është cënuar fshehtësia gjatë procesit të votimit. Cënimi i fshehtësisë së votimit është një parregullsi që nuk ka lidhje me procedurën e numërimit, vlerësimit dhe tabulimit të rezultatit, d.m.th. nuk mund të jetë pjesë e kërkesës për ndryshimin e tabelës përmbledhëse, por votat e pavlefshme kanë lidhje me këtë procedurë. Votat e pavlefshme janë përcaktuar në mënyrë ezauruese nga dispozita e nenit 117 të Kodit Zgjedhor. Pika 3 e këtij neni përcakton:

3. Vota të pavlefshme janë fletët e votimit kur:

- a) fleta e votimit nuk ka të njëjtën madhësi, ngjyrë ose formë me fletën e votimit të miratuar nga KQZ-ja;*
- b) fletës së votimit i mungojnë vulat e parashikuara në nenin 103 të këtij Kodi;*
- c) në fletën e votimit janë bërë shënime apo shenja që bëjnë të pamundur vlerësimin e votës;*
- ç) në fletën e votimit janë bërë shënime në favor ose në disfavor të subjekteve të caktuara zgjedhore;*
- d) është votuar për më shumë se një nga subjektet zgjedhore në fletën e votimit;*
- dh) nuk është votuar për asnjë nga subjektet zgjedhore në fletën e votimit;*

e) është votuar për një subjekt zgjedhor dhe për kandidatin e një subjekti tjetër zgjedhor;

e/1) nuk është e qartë se për kë është votuar; ose

ë) zgjedhësi ka votuar për një person apo subjekt që nuk është në fletën e votimit.

Votat e cilësuar nga ankuesi si “vota të pavlefshme” nuk janë të tilla, sipas nenit 117 të Kodit Zgjedhor. Ato nuk mund të identifikohen në proces numërimi dhe nuk mund të hiqen nga tabela përmbledhëse e rezultatit dhe, së fundi, ato nuk janë “rreth 1200 vota të pavlefshme”. KAS-i konstatoi nga këqyrja e provave, se shifra ishte e ekzagjeruar (shih analizën për QV-në nr,3494).

3. Ankuesi pretendoi se “ka patur shumë mosrakordime në numër votash në çdo tavolinë, kjo për faktin e prishjes dhe fallsifikimit të materialit zgjedhor”. Në mënyrë të veçantë ankuesi pretendoi për “skenar mbulimi të mosrakordimit në numër votash fizikisht me atë të shënuar në procesverbale” për QV nr. 3525 dhe për QV-në nr. 3526, por edhe në këtë rast nuk provoi pretendimin. KAS-i provoi më sipër se “fakti i prishjes dhe fallsifikimit të materialit zgjedhor” ishte i pavërtetë, sepse bazohej në një “provë” fallso dhe të fabrikuar. Por ankuesi kishte jo vetëm mundësinë, por edhe detyrimin ligjor që të demonstronte nëpërmjet pamjeve video nga tavolinat e numërimit çdo pretendim për mosrakordim, sikurse kishte mundësinë që të kërkonte verifikimin në kuti për këto dy qendra votimi. Në vend të kësaj, ankuesi kërkoi rinumërimin e të gjitha votave apriori dhe pa mbështetje ligjore.
4. Procedura e votimit dhe ajo e numërimit të votave janë procedura transparente dhe të dokumentuara në çdo hap. Kodi Zgjedhor është kujdesur që ato të zhvillohen në sytë e përfaqësuesve të subjekteve, vëzhguesve të pavarur dhe të publikut, si dhe çdo problem, parregullsi apo shkelje e ligjit të dokumentohet në procesverbalet tip dhe librat e protokollit të komisioneve përkatëse, si dhe të filmohet nga kamerat mbikëqyrëse të procesit, me qëllim që të shërbejë si provë materiale në proceset eventuale për kundërshtimin e rezultatit apo të zgjedhjeve në tërësi. Provat dhe mjetet mbrojtëse janë të disafishta dhe konkurruese me njera tjetrën. Ato nuk lënë boshllëk edhe nëse ndonjera prej tyre nuk funksionon.

5. Dokumentacioni që prodhohet nga administrata zgjedhore gjatë zbatimit të procedurave të votimit dhe të numërimit të votave bën pjesë në radhën e parë dhe kryesore të provave ku mund të mbështeten kërkesat ankimore me objekt ndryshimin e Tabelës Përmbledhëse të Rezultatit të Zonës Zgjedhore ose/dhe pavlefshmërinë e rezultatit në një apo disa qendra votimi. Subjektet zgjedhore kanë akses mbi këtë dokumentacion, në disa raste disponojnë *ipso lege* kopje të tij. Nga ana tjetër, Kodi Zgjedhor u njeh palëve edhe të drejtën për të vënë në lëvizje KQZ-në për marrjen e provave “për të vërtetuar faktet, në rast se nuk ka qenë e mundur që këto prova të siguroheshin paraprakisht prej tyre, duke paraqitur njëkohësisht edhe arsyet përse nuk ka qenë i mundur sigurimi i tyre”.
6. Pika 1, e nenit 82 të K.Pr.A saktëson: “në procedurat administrative, të filluara me kërkesë të palës që inicion procedurën, barra e provës për faktet e pretenduara bie mbi këtë palë, pavarësisht nga detyrimi i organit publik për të vënë në dispozicion të palëve provat e zotëruara prej tij”. Këtë detyrim e vendos edhe Kodi Zgjedhor nëpërmjet shkronjës “b” të pikës 1, të nenit 136, kur u kërkon palëve “të tregojnë faktet dhe provat, mbi të cilat mbështesin pretendimet e tyre”.
7. Kodi Zgjedhor kërkon në mënyrë të shprehur që pretendimet të jenë të mbështetura në prova, sepse Kodi kërkon që t’i presë rrugën e suksesit kërkimeve të pathemelta ose me ves. Kjo do të thotë, se Kodi kërkon që raporti midis pretendimit dhe provës të jetë i drejtpërdrejtë, thënë ndryshe, prova duhet të shërbejë për të mbështetur drejtpërdrejt pretendimin. Pika 4 e nenit 136 të Kodit Zgjedhor saktëson, se “KQZ-ja mund të refuzojë kërkesën e ankuesit apo të palës së interesuar për marrjen e provave, sipas shkronjës “c” të pikës 1 dhe pikës 2 të këtij neni, vetëm nëse vlerëson se prova nuk shërben për të vërtetuar faktet e pretenduara”. Nga ana tjetër, kjo do të thotë se në raportin midis provës dhe pretendimit, prova vjen e para. Provat ekzistojnë përpara pretendimit, nuk krijohen për shkak të tij.
8. Nga shqyrtimi në tërësi i kërkesës për ndryshimin e tabelës përmbledhëse të rezultatit dhe i pretendimeve të lidhura me të, KAS-i del në konkluzionin së si kërkesa, ashtu dhe pretendimet janë ngritur në mungesë të plotë të provave respektive dhe ankuesi nuk ka bërë përpjekje as serioze, as të mjaftueshme për t’i siguruar ato as paraprakisht, as përgjatë shqyrtimit të ankimit,

pavarësisht kohës së gjatë që KAS-i i la në dispozicion për të hulmtuar provat tek materiali zgjedhor. Kjo është arsyeja pse kjo kërkesë duhet të rrëzohet nga KAS-i.

III Lidhur me pretendimet dhe provat e paraqitura

1. Bërthama e pretendimeve të ankuesit sa i takon periudhës parazgjedhore në zonën zgjedhore bashkia Kuçovë lidhet me akuza në drejtim të kandidatit konkurrent për keqpërdorim të burimeve publike, si kur ato kanë qenë në formën e aseteve (investime), ashtu edhe kur ato shfaqen si personel dhe administratë e institucionit të bashkisë. Ankuesi ka ndjekur në mënyrë të veçantë veprimtaritë për shpërndarjen e ndihmave materiale për familjet në nevojë, duke e konsideruar këtë veprimtari, si veprimtari me qëllime të pastra elektorale, prandaj e ndaluar dhe e dënueshme. Një komponent i veçantë i analizës së ankuesit ka qenë kryerja e investimeve private në vepra publike, si kontribut i kundraligjshëm për fushatën elektorale të kandidatit konkurrent.
2. Ankimet për periudhën parazgjedhore ankuesi nuk i ka lidhur me ndonjë kërkim, prandaj pretendimet dhe provat përkatëse nuk mund të alokohen tek objekti i kërkesës. Një pjesë prej tyre, gjithësesi janë të dobishme për procedurat paszgjedhore të KQZ-së. Provat dhe argumentat për investime private në vepra publike apo për shpërndarje të ndihmave për llogari të Kryqit të Kuq ose në bashkëpunim me të mund t'i shërbejnë procesit të raportimit financiar, monitorimit dhe auditimit të financave të kandidatit. Provat në kuadër të keqpërdorimit të burimeve publike mund t'i shërbejnë procedurave hetimore të KQZ-së për keqpërdorimin e burimeve publike. Për këtë arsye, KAS-i i kërkon administratës së KQZ-së që t'i marrë në administrim këto prova dhe të procedojë sipas kompetencës, nëse konsideron se ka bazë të mjaftueshme për hetimin e kundërvajtjeve administrative.
3. Sa i takon pretendimeve lidhur me parregullsitë në ditën e votimit, ankuesi evidenton kryesisht atë që ai e cilëson "votimi në grup", parregullsi në administrimin e materialit zgjedhor, mungesë procesverbalesh në kuti dhe ndryshimin, sipas tij, pa justifikim ligjor të kodeve të sigurisë të kutive. Ankuesi i paraqiti KAS-it një seri provash të nxjerra nga materialet video nga regjistrimet e kamerave vëzhguese të QV-ve, për të provuar votimin në grup dhe shkelje të tjera gjatë votimit,

por asnjë provë nga procedura e administrimit të kutive dhe të procesit të numërim/vlerësimit të votave.

4. Provat për parregullsi përgjatë procedurave të votimit në grup përfshijnë ekstrakte të materialit video nga regjistrimi i kamerave vëzhguese kryesisht të QV-ve nr. 3494, nr. 3524/01 nr. 3426, nr. 3531, nr. 3519/02. Përgjithësisht votimi në grup paraqitet në trendin e përgjithshëm të kësaj forme të shkeljes së procedurës së votimit, me përjashtim të QV-së nr. 3493. KAS-i, pasi këqyri provën për këtë QV (u administruan vetëm materialet video me provat e specifikuara, kurse materialet bruto nuk u morën në konsideratë), arriti të identifikonte të paktën 102 raste të cënimit të fshehtësisë së votimit dhe, brenda tyre, 25 raste të votimit të asistuar të parregullt dhe të paktën 7 raste të votimit të asistuar të paligjshëm. Parregullsia e votimit të asistuar konsistonte në faktin se në asnjëri nga këto raste nuk u zbatua procedura e nënshkrimit të deklaratës nga zgjedhësi asistues, kurse paligjshmëria konsistonte në faktin se u lejua të asistonte komisionerët (në 5 raste) dhe në dy raste u lejua asistimi për më shumë se një person.
5. Në QV-në nr. 3494 kanë votuar 373 zgjedhës. Numri i lartë i rasteve të cënimit të fshehtësisë së votimit është indikator i faktit se në këtë QV ka pasur marrëveshje midis anëtarëve të komisionit për “të lejuar votimin familjar”. Kur ka marrëveshje komisioni, kjo formë votimit shndërrohet nga parregullsi, në skemë për kontrollin e votës dhe për intimidimin e zgjedhësve. Ekzistenca e një marrëveshjeje apo vendimi midis anëtarëve të KQV-së për të lejuar votimin familjar, për pasojë për të asgjësuar fshehtësinë e votimit e dallon rastin e denoncuar për këtë QV nga të gjitha QV-të e tjera ku provohet votimi në grup ose familjar dhe ku ai është sporadik, i neglizhuar ose i toleruar, por jo i kërkuar, i nxitur, i promovuar institucionalisht. Midis provave të paraqitura nga ankuesi ka të paktën 3 prova që shkojnë në favor të konkluzionit për ekzistencën e kësaj marrëveshjeje të kundërligjshme midis anëtarëve të KQV-së (provat: QV-3494-18_komisioneret i sugjerojne votueses te futet te grupimi i shtetasve te cilet po votonin.mp4, QV-3494-11 votim ne grup sebashku me antaret e qv.mp4, QV-3494-16 kryetarja e komisionit voton per shtetasen.mp4). KAS-i u ndal gjatë në analizën e kësaj prove, por jo të gjithë anëtarët krijuan bindjen se provat e identifikuar mund të lexoheshin me bindje si provë e pakundërshtueshme e marrëveshjes së kundërligjshme midis anëtarëve të KQV-së. **Ngritja dhe vënia në funksionim nga ana e KQV-së e skemave që asgjësojnë fshehtësinë e votimit është shkak për të shpallur**

pavlefshmërinë e zgjedhjeve në qendrën e votimit. Por ky vendim mund të merret vetëm kur votojnë pro tij jo më pak se 4 anëtarë të KAS-it. Kjo është arsyeja pse KAS-i nuk deklaroi pavlefshmërinë e zgjedhjeve në këtë qendër votimi.

6. Pretendimet për ndryshimin e pajustificueshëm të një numri kodesh sigurie të kutive të votave e të materialeve zgjedhore rezultuan të pathemelta pas verifikimit me librin protokollit. Të gjitha procedurat ishin kryer konform ligjit dhe me shkak të qartë ligjor. Po kështu, pretendimet për mungesë procesverbalesh të mbylljes së kutive nuk korrespondojnë me shënimet në librin e protokollit. Pretendimet për votim për më shumë se një herë rezultuan të paprovuara, kurse pretendimi për një rast nxjerrjeje vote jashtë qendrës së votimit rezultoi i paprovueshëm. Materiali video provon se votuesi “zhduk” fletët e votimit dhe nuk shkon drejt kutisë, por veprimet e mëtejshme të tij nuk mund të ndiqen, sapo ai del nga kuadri i kameras vëzhguese. Kjo provë kërkon hetim, i cili nuk mund të bëhet me instrumentat e hetimit administrativ. Pretendimet e tjera ishin pa lidhje me kërkimin, por edhe pa peshë për të gjykuar për ekzistencën e shkaqeve për pavlefshmëri zgjedhjesh.
7. KAS-i analizoi në tërësi pretendimet dhe provat edhe në këndvështrimin e ekzistencës së shkaqeve ligjore për pavlefshmëri. Me përjashtim të diskutimit për procedurat e votimit në QV- në nr. 3494, për të cilat pati diferenca qëndrimesh, për çështjet e tjera KAS-i konkludoi se asnjëra nga rrethanat e faktuara nuk formonte dot shkak pavlefshmërie zgjedhjesh, në kuptimin që ka pavlefshmëria nga këndvështrimi i ligjit, doktrinës dhe jurisprudencës zgjedhore shqiptare.
8. Neni 160 i Kodit Zgjedhor përcakton si shkaqe për shpalljen e pavlefshmërisë së zgjedhjeve:
 - f) shkelje të ligjit, të cilat kanë cenuar rëndë procesin zgjedhor ose tërësi shkeljesh të ligjit, të cilat mund të kenë cenuar procesin zgjedhor në një masë të tillë, që mund të ketë ndikuar në ndarjen e mandateve në zonën zgjedhore;
 - g) fatkeqësi natyrore në përmasa të tilla, që kanë penguar pjesëmarrjen e zgjedhësve në votim; ose
 - h) mosfillim i votimit apo pezullim i tij për më shumë se pesë orë.

9. KAS-i e ka trajtuar gjerësisht analizën ligjore për kërkimin e pavlefshmërisë së zgjedhjeve në vendimarrjen e tij për zgjedhjet parlamentare të vitit 2021 (p.sh. vendimet nr.89, datë 20.05.2021, nr. 91, datë 27.05.2021, nr. 94, datë 31.05.2021, nr. 95, datë 31.05.2021 etj.) Në këto vendime, KAS-i ka arsyetuar, se neni 160 i Kodit Zgjedhor përcakton si **tipar kryesor për shkeljet e ligjit, me qëllim që ato të trajtohen si shkak për pavlefshmërinë e zgjedhjeve, peshën e tyre dëmprurëse mbi zgjedhjet**. Në këto raste dëmi mund të vijë edhe nga një shkelje e vetme, por tronditëse për zgjedhësit ose rregullshmërinë e procesit (p.sh. cënimi i integritetit të kutive të votimit - nenet 115 dhe 138 të KZ). Përgjatë zgjedhjeve mund të ndodhin parregullsi apo shkelje të shumta, të lehta ose të rënda, të cilat mund të kenë lidhje me aspekte të veçanta të procesit, por jo të gjitha mund të cilësohen “shkelje që çënojnë rëndë procesin zgjedhor”. **Shkelje që çënojnë rëndë procesin zgjedhor janë vetëm shkeljet që ose i pengojnë/largojnë zgjedhësit në masë nga votimi, ose që i detyrojnë ata të votojnë në masë kundër vullnetit të tyre, ose që tjetërsojnë në masë votën e hedhur**. Votimi familjar p.sh. që është konstatuar shpesh nga misionet vëzhguese të OSBE/ODIHR-it si shkelje e procesit zgjedhor nuk është konsideruar nga ata kurrë si shkelje që shkakton pavlefshmërinë e zgjedhjeve, sepse ata nuk e kanë vëzhguar asnjëherë këtë shkelje në masën e vet kritike. Po kështu shitblerja e votës, që gjithashtu është kritikuar në një numër zgjedhjesh, nuk është vëzhguar prej tyre në masë kritike.
10. KAS-i ka vlerësuar se **masa kritike është kriteri kyç në gjykimin e kërkesave për pavlefshmëri të zgjedhjeve**. Masa kritike ndryshon nga një vend në tjetrin, nga një demokraci në tjetrën, sepse masa kritike varet tërësisht nga shkalla e zhvillimit demokratik. Në çdo demokraci qëllimi është zhvillimi i zgjedhjeve dhe legjitimitimi i pushtetit nga populli. Masa kritike është instrumenti që mbron zgjedhjet dhe demokracinë nga deligjitimitimi.
11. KAS-i ka analizuar se Kodi Zgjedhor ka përpunuar mjete ligjore mbrojtëse të ndryshme për shkelje të ndryshme. Për një pjesë prej tyre, mjeti ligjor mbrojtës është gjoba administrative (shkeljet e kryera nga media, subjektet zgjedhore, përfaqësuesit e institucioneve), për një pjesë janë masat disiplinore (shkarkimi etj.), për një pjesë është ndjekja penale (shitblerja e votës, shpërdorimi i detyrës, korrupsioni aktiv dhe pasiv në zgjedhje etj.), por për asnjërën prej tyre Kodi nuk ka përcaktuar si mjet ligjor pavlefshmërinë e zgjedhjeve. Kjo është arsyeja pse ekzistenca e një apo më shumë shkeljeve, qofshin këto edhe të rënda, nuk është shkak i vetëmjaftueshëm për të

kërkuar pavlefshmëri. Kjo është arsyeja pse kërkesat për pavlefshmëri duhet të shoqërohen patjetër me argumentimin juridik, që vërteton se shkelja e pretenduar është “shkelje që çënon rëndë procesin zgjedhor”, sikurse duhet të shoqërohen edhe me provën se sa dhe si e ka çënuar ajo procesin zgjedhor. Nevoja për provueshmëri imponon edhe nevojën për të provuar lidhjen shkakësore midis shkeljes dhe pasojës së rëndë, pengimit/largimit të zgjedhësve në masë nga votimi, detyrimit të tyre që të votojnë në masë kundër vullnetit, ose tjetërsimit në masë të votës së hedhur.

12. Kodi Zgjedhor lejon si shkak për pavlefshmërinë edhe një tërësi shkeljesh të ligjit, të cilat mund të kenë çënuar procesin zgjedhor në një masë të tillë, që mund të ketë ndikuar në ndarjen e mandateve në zonën zgjedhore. Në dallim nga shkakun themelor, ky rast kërkon më shumë se sa një shkelje, me një shkallë më të ulët cënimi. Në këtë rast nuk duhet që të ketë pasur pengim/largim të zgjedhësve në masë nga votimi, detyrim të tyre që të votojnë në masë kundër vullnetit, apo tjetërsim në masë të votës së hedhur, por mjafton që ky fenomen (pengimi/largimi i zgjedhësve nga votimi, detyrimi për të votuar kundër vullnetit, apo tjetërsimi i votës) të ketë ndodhur në atë shkallë, sa të mund të ketë ndikuar në ndarjen e mandateve. Edhe në këtë rast, kërkesat për pavlefshmëri duhet të shoqërohen patjetër me argumentimin juridik pse shkelja e pretenduar është “shkelje që mund të ketë ndikuar në ndarjen e mandateve”, si dhe me provën për përmasën e ndikimit dhe lidhjen shkakësore.
13. KAS-i ka kërkuar që argumentet për shpalljen e pavlefshme të zgjedhjeve të jenë konkrete, të faktueshme, të provueshme dhe të matshme. Këto kërkesa që burojnë nga dispozita e pikës 1 të nenit 160 të Kodit Zgjedhor janë konfirmuar edhe nga jurisprudenca kushtetuese dhe zgjedhore shqiptare. Vendimi nr.75, datë 19.04.2002 i Gjykatës Kushtetuese, i cili mund të shërbejë si bazë për të identifikuar metodologjinë për saktësimin dhe konkretizimin e termit “shkelje që çënojnë rëndë procesin zgjedhor”, kërkon që arsyetimi juridik i KAS-it të kalojë nëpërmjet “përcaktimit të kriterëve, koncepteve bazë si dhe parimeve mbi të cilat duhet të mbështetet organi kompetent për të konkluduar lidhur me aplikimin e shkakut të përshtatshëm kushtetues”. **Shkeljet që çënojnë rëndë procesin zgjedhor duhet të jenë shkelje të tilla që e bëjnë të pavlerë rezultatin e tyre**, sikurse “aktet e sjelljet që diskreditojnë rëndë pozitën dhe figurën... (duhet të

jenë të tilla që) e bëjnë të pamundur kryerjen e mëtejshme të funksioneve kushtetuese” për zyrtarin e lartë.

14. KAS-i, në shqyrtimin e kërkesave për pavlefshmëri është udhëhequr nga jurisprudenca e Kolegjit Zgjedhor, i cili është marrë posaçërisht me interpretimin e pikës 1 të nenit 160 të Kodit Zgjedhor, sipas tekstit që është sot në fuqi, në vendimin e tij nr.45, datë 18.11.2013. Kolegji ka konfirmuar karakterin përjashtimor të rasteve të pavlefshmërisë dhe përsëritjes së zgjedhjeve. Sipas Kolegjit Zgjedhor **“përsëritja e zgjedhjeve nuk mund të kryhet për çdo shkelje të evidentuar, qoftë kjo edhe lidhur me parimet e zgjedhjeve, përveçse kur provohet se shkeljet janë të tilla që kanë ndikuar në rezultatin final”**. Kolegji Zgjedhor çmon se nuk mjafton që të provosh se janë kryer shkelje që kanë cënuar procesin zgjedhor për të kërkuar pavlefshmërinë e zgjedhjeve, por duhet të provosh se “këto shkelje të jenë në një masë të tillë sa të mund të kenë ndikuar në ndarjen e mandatit”. Gjithashtu, Kolegji ka saktësuar se pretendimi se shkelja “përbën fenomen masiv, ndaj edhe mund të ketë ndikuar në rezultatin e zgjedhjeve” duhet të provohet në gjykim, përndryshe ngelet në kuadrin e një hipoteze dhe nuk mund të merret për bazë nga gjykata.

IV Lidhur me kërkesat procedurale

1. Ankuesi kërkoi në seancë vendosjen në sekuestro të të gjitha materialeve zgjedhore të zgjedhjeve për bashkinë Kuçovë, për shkakun se po vononte plotësimi i kërkesave për marrjen e provave nga administrata. KAS-i e rrëzoi këtë kërkesë me arsyetimin se KAS-i nuk ka kompetencë ligjore për të vendosur sekuestro. KAS-i është trupë e pavarur që vepron në kuadër të KQZ-së dhe që asistohet në veprimtarinë e vet nga administrata e KQZ-së. Plotësimi i kërkesës do të thonte që KAS-i t’ia hiqte nga administrimi materialet zgjedhore administratës së KQZ-së për t’ia dhënë në ruajtje dhe administrim po administratës së KQZ-së!!! Për më tepër, vendosja e sekuestros nënkupton mosjelimin e administratës që t’i vërë në dispozicion provat e kërkuara ankuesit!!! Për këtë arsye, bashkë me rrëzimin e kërkesës, KAS-i i kërkoi administratës që të përshpejtonte vënien në dispozicion të provave.
2. Ankuesi kërkoi thirrjen në cilësinë e dëshmitarëve të z. Kreshnik Hajdari dhe z. Pëllumb Salillari, KAS vendosi fillimish t’a çmojë këtë kërkesë në përfundim të shqyrtimit të provave shkresore. Pas përfundimit të hetimit administrativ, KAS nuk e pa të nevojshme thirrjen e dëshmitarëve në

këtë fazë të procesit, pasi dëshmitë e tyre nuk ndihmojnë në provimin/vërtetimin e fakteve që janë qëllim i këtij procesi, dhe si të tillë, vendosi rrëzimin e kësaj kërkesë.

3. Ankuesi kërkoi që KAS-i t'i kërkojë policisë së shtetit informacion nga sistemi TIMS për 1 person objekti kërkimi, nëse ka hyrë përpara ose në ditën e zgjedhjeve në territorin e Republikës së Shqipërisë, për të cilin ankuesi kishte bërë përçapjet sipas ligjit, por nuk kishte mundur t'a siguronte informacionin. Informacioni ishte i rëndësishëm, sepse ky person rezultonte votues në QV-në nr. 3417 Krekëz, në të cilën pajisja PEI nuk kishte funksionuar dhe kamera vëzhguese e QV-së nuk ka qenë e fokusuar dhe nuk lejonte verifikimin e prezencës së votuesve. Sipas informacioneve të ankuesit ai dhe rreth 45 persona të tjerë nuk kanë qenë të pranishëm brenda territorit. KAS-i e rrëzoi këtë kërkesë, sepse sistemi TIMS nuk jep dot përgjigje të sigurtë dhe përfundimtare për praninë ose jo të shtetasve brenda territorit. Për më tepër, nga përfaqësuesit e administratës së KQZ-së në seancë u përcoll informacioni se në këtë QV kishte funksionuar pajisja PEI. Bazuar në këtë të dhënë, KAS-i bëri verifikimin nga materiali zgjedhor në administrim të KQZ-së dhe rezultoi se ky person nuk ka votuar në zgjedhjet e datës 14 maj 2023. Pajisja PEI e QV-së nr. 3417 nuk ka asnjë rekord me identitetin e tij (shkresa nr. 6021, datë 15.06.2023 e Sekretarit të Përgjithshëm Ylli Merkaj).
4. Ankuesi paraqiti dy kërkesa për pezullimin e shqyrtimit të ankimit në KAS, me arsyetimin se kishe depozituar kërkesë padi ndaj dy vendimeve të ndërmjetme të KAS-it, së pari ndaj vendimit nr. 136, datë 24.05.2023 dhe së dyti ndaj vendimit të KZAZ-së të datës 12.06.2023 për rrëzimin e kërkesës për rinumërimin dhe rivlerësimin e të gjitha votave të hedhura në zgjedhjet për kandidatët për kryetar bashkie në bashkinë Kuçovë. Kërkesa e parë u pranua nga KAS-i me arsyetimin se padia ishte ngritur ndaj vendimit të pranimit për shqyrtim dhe se afati i pezullimit ishte i nevojshëm për palën për të marrë në dispozicion dhe për të këqyrrur provat e kërkuara nga administrata e KQZ-së. Kërkesa e dytë u rrëzua, sepse vendimi në fjalë është vendim që nuk i nënshtrohet ankimit veçmas, por vetëm me vendimin përfundimtar, sepse arsyetimi i tij është pjesë e vendimit përfundimtar dhe, për këtë arsye, ankuesit i mungon lënda për ngritjen e padisë, nëse pezullohet dalja e vendimit përfundimtar.
5. Ankuesi kërkoi rinumërimin dhe rivlerësimin e të gjitha votave për kandidatët për kryetar bashkie. Kërkesa u paraqit në kuadër të kërtimeve për marrjen e provave dhe u refuzua nga KAS-i si pa

bazë ligjore. KAS-i ka vendosur në mënyrë të përsëritur lidhur me kërkesat për rinumërim dhe ka shpjeguar kontekstin ligjor kur merret dhe administrohet vendimi për rinumërim dhe provat e dala nga rinumërimi. Në mënyrë të përmbledhur shkaqet e refuzimit paraqiten më poshtë:

- (i) Kodi Zgjedhor njeh rinumërimin dhe/ose rivlerësimin e votave përgjatë procedurës ankimore, por Kodi e pranon rinumërimin dhe/ose rivlerësimin e votave vetëm për vota të caktuara dhe vetëm në rrethana tejet specifike. Vota të caktuara janë, sipas pikës 3 të nenit 138 të Kodit Zgjedhor, “votat e identifikuara ose të kontestuara, sipas procedurave të neneve 116 dhe 118 të këtij Kodi, për të cilat është kontestuar vlerësimi ose numri i tyre gjatë procesit të numërimit, si dhe votat e tabelës së rezultatit të kundërshtuar, sipas pikës 2 të nenit 119 të këtij Kodi”. Kjo do të thotë se numërimi dhe/ose vlerësimi i votave duhet të jenë shoqëruar me kontestime apo me konstatimin e pasaktësive, për to duhet të jenë bërë shënimet përkatëse në fletët e kontestuara, në tabelën e rezultateve të kontestuara apo në librin e protokollit të KZAZ-së, me qëllim që ato të mund t’i nënshtrohen procedurës së rinumërimit dhe/ose rivlerësimit.

- (ii) Neni 116 i Kodit Zgjedhor përcakton se kur shifra e totalit të fletëve të votimit të gjetura në kuti nuk përputhet me shifrën për pjesëmarrjen e zgjedhësve të shënuar në Procesverbalin e Mbylljes së Votimit, atëherë KZAZ-ja e pasqyron pasaktësinë në Procesverbalin e Konstatimit. Neni 118 përcakton procedurën e administrimit të fletëve të kontestuara, të cilat, pas kontestimit, rivlerësohen nga GNV-ja dhe, nëse kontestimi mbahet në këmbë, vlerësohen nga KZAZ-ja. Rezultati i shpallur shënohet në librin e protokollit të KZAZ-së dhe përfshihet në tabelën përkatëse të rezultatit të qendrës së votimit që harton grupi i numërimit të votave. Për secilën fletë të kontestuar, në pjesën e prapme të saj numëruesi i parë i Grupit të Numërimit shënon qartë arsyet e kontestimit. Për votat e kontestuara mbahet një procesverbal i veçantë, në të cilin pasqyrohet numri i përgjithshëm i fletëve të votimit të kontestuara për QV-në përkatëse. Në përfundim të nxjerrjes së rezultatit, fletët e votimit të kontestuara dhe procesverbali përkatës futen në zarfin e “FLETËVE TË VOTIMIT TË KONTESTUARA”. Neni 119 përcakton se kur ka kontestime për tabelën e rezultateve për qendrën votimit që harton GNV-ja, kontestet e anëtarëve të GNV-së shënohen në tabelë,

kurse kontestimet e vëzhguesve të subjekteve zgjedhore shënohen në librin e protokollit të KZAZ-së.

(iii) Rinumërimi dhe/ose rivlerësimi i votave nuk bëhet pa procedurë paraprake kontestimi. Kjo do të thotë se nuk mund të ketë rinumërim dhe/ose rivlerësim thjesht dhe vetëm për shkakun se diferenca e votave midis dy kandidatëve konkurrues është më e vogël se numri i votave të pavlefshme. Rinumërimi ipso lege ka qenë njohur nga Kodi Zgjedhor në formatin e tij fillestar të vitit 2000, por ligjvënësi hoqi dorë shpejt nga ky modalitet. Kërkesa për rinumërim për diferencë të ulët votash sot është pa bazë ligjore. Po kështu, nuk mund të ketë rinumërim dhe/ose rivlerësim për shkak të pretendimit se rezultati i votimit duket “i panatyrshëm”, “i çuditshëm”, “i paarsyeshëm”, “i pabesueshëm”, apo bazuar në ‘dyshime të arsyeshme’ se mund të ketë pasur gabime, pasaktësi, parregullsi apo devijime në tabulim. Rinumërimi dhe/ose rivlerësimi i votave nuk mund të bëhet thjesht dhe vetëm për shkak se vëzhguesit e subjektit kanë tabuluar rezultat të ndryshëm nga rezultati i tabuluar nga GNV-të, apo për shkakun se ata nuk ka në qenë të pranishëm në procedurën e numërimit fillestar. Pretendimet e vëzhguesve të subjektit nuk formojnë provë dhe prania e tyre në numërim nuk është kusht për vlefshmërinë e numërimit. Vëzhguesit janë pjesë e subjektit dhe pretendimet e tyre, ashtu si çdo pretendim tjetër i subjektit duhet të provohen nga ankuesi, përpara se çështja të marrë zgjidhje ligjore.

(iv) KAS-i i dha mundësinë dhe kohën ankuesit që t’i këqyrte pamjet video dhe të sillte provat e nevojshme për të mbështetur dhe provuar kërkesën për hapjen dhe këqyrjen e votave në kuti. Ankuesi e neglizhoi tërësisht këtë mundësi dhe nuk paraqiti asnjë provë të vetme bazuar në pamjet video të kamerave të tavolinave të numërimit, duke e lënë kërkesën për rinumërim dhe rivlerësim të të gjitha votave, pa asnjë bazë ligjore.

6. Kërkesa e fundit e ankuesit ishte kërkesa për përjashtimin e trupës së KAS në tërësi. Kjo kërkesë u rrëzua si kërkesë abusive, ekstraprocedurale dhe pa bazë ligjore. Për këtë arsye, KAS vendosi rrëzimin e kësaj kërkesë.

V Konkluzion

1. Bazuar në këtë analizë ligjore dhe faktike, KAS-i duhet të rrëzojë në tërsi kërkesat e të dy ankuesve, si të pa mbështetura në prova e në ligj.

PËR KËTO ARSYE:

Mbështetur në nenet 21 pika 1 shkronja “c” dhe 143 pika 1 shkronja “d” të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, me shumicë votash, Komisioni i Ankimimeve dhe Sanksioneve

V E N D O S I:

1. Rrëzimin e kërkesës ankimore nr. 67, datë 20.05.2023, të depozituar nga koalicioni “Bashkë Fitojmë”.
2. Rrëzimin e kërkesës ankimore nr. 74, datë 22.05.2023, të depozituar nga z. Lefter Maliqi, kandidat i koalicionit “Bashkë Fitojmë” për kryetar bashkie Kuçovë.
3. Lënien në fuqi të vendimit nr. 101, datë 16.05.2023 të KZAZ nr. 64, bashkia Kuçovë, qarku Berat “Për miratimin e Tabelës Përmbledhëse të Rezultateve për zgjedhjen e Kryetarit të Bashkisë Kuçovë”.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.

Bazuar në pikën 1 të nenit 145 të Kodit Zgjedhor, kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Kolegjin Zgjedhor Gjyqësor pranë Gjykatës Administrative të Apelit, brenda 5 ditëve nga shpallja e tij, sipas përcaktimit të pikës 2 të nenit 152 të Kodit Zgjedhor.

U shpall sot më 13.06.2023.

Koli	BELE	-	Relator	
Elvin	LAKO	-	Anëtar	
Elvis	ÇEFA	-	Anëtar	
Ilirjan	RUSMALI	-	Anëtar	
Ledio	BRAHO	-	Anëtar	(Kundër)